

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Urë Vajguore, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Blerje materiale inerte”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT : (FPP) Çakëll,
Materiale ndërtimi dhe produkte të ngjashme, Materiale ndërtimi.

Fondi limit: 3 750 000 (tre milion e shtateqind e pesedhjetë mijë) lekë pa tvsh

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin ekriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

Sipas percaktimeve të vendosura në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe të vecanta të kualifikimit (Shtojcat).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet e viteve, tre viteve të fundit 2023,2024,2025, të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.2.2.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogarit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2024 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për

sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024, bazuar ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respective të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- c) **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **jo** më të vogël, se 20% e vlerës së fondit limit të lotit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatoret ekonomike pjesemarres duhet te kene nje punesim mesatar jo me pak se 5 (pese) punonjesish, per tre muajt e fundit, te vertetuar me:

- Listepagesat ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj per periudhen Shkurt 2026- Prill 2026.
- *Kriteri per piken 2.3.1 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.3 Te jete pajisur me leje shfrytezimi minerar, te leshuar nga Autoriteti perkates.

Argumentimi: Bazuar ne ligjin nr. Ligjin Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Leje per shfrytezim minerar kerkohet per shfrytezimin e mineraleve dhe materialeve te ndertimit te ndodhur ne zonen e shfrytezimit. Ky kriter kerkohet nga ana jone per arsye se ndikon ne cmimin ofertues te operatoreve ekonomik si verteton faktin qe operatori ekonomik eshte i miratuar nga Autoriteti perkates per objektin tone te prokurimit dhe zoterojne eksperiencen e duhur per te gjitha nivelet e punes. Ky kriter verteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.4 Te kete leje per perdorim civil te lendeve plasese si subjekt i specializuar, leshuar nga Autoriteti perkates.

Argumentimi: Bazuar ne ligjin nr. 9126, date 29.7.2003 ”Per perdorimin civil te lendeve plasese ne republiken e shqiperise”. Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur është përcaktuar qartesisht dhe se kategoria e shërbimit te kerkuar eshte e nevojshme per nxjerrjen e materialit minerar. Ky kriter verteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.5 Te kete impiant prodhimi, per te vertetuar kete kriter operatori ekonomik duhet te paraqese fatura ose kontrat qiraje/ kontrate furnizimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë impjant prodhimi në pronësi/qera ose kontratë furnizimi. Për të vërtetuar pronësinë e impjantit, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë e impjantit (Faturë tatimore blerjeje/Kontratë blerjeje/Planvendosje e impjantit në kantier, etj).

Për kontrata të qerasë ose të furnizimit, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë kontratën përkatëse me objekt dhe afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Numri i makinerive është përcaktuar duke u mbështetur në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve dhe grafikut të punimeve pra vërteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Te jete i pajisur me leje mjedisore te produkteve minerare te tipit B.

Argumentimi: Bazuar në Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive që perfshihen në kategorinë B. Autoriteti Kontraktor e gjen të arsyeshme të kërkojë këto kriter të vendosur nga ana jone në zbatim të ligjit të sipërcituar për kategoritë e veprimtarive që ndikojnë në mjedis. Ky kriter vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.7 Te kete ne pronesi ose me qira 1(nje) sonde shpimi. Per te vertetuar kete operatori ekonomik duhet te paraqese fatura ose kontrate qiraje.

Argumentimi: Në bazëtë pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Numri i makinerive është përcaktuar duke u mbështetur në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve dhe grafikut të punimeve pra verteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.8 Te kete ne pronesi ose me qira 1 (nje) kamion deri 20 ton. Per te vertetuar kete operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentin perkates, ose kontrate qiraje, lidhur perpara noterit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Kërkohet 1 (nje) kamion deri 20 ton për shkak të distancave të gjata të kryerjes së punimeve dhe sasisë së konsiderueshme të mallit të kërkuar për tu ezauruar si sasi totale brenda afatit të përcaktuar në grafikun e

lëvrimit të mallit, si edhe të përfitimit të kohës për realizimin e kontratës brenda afateve të përcaktuara. Pra, automjetet e mesiperme, nevojiten për kryerjen e transportit të mallit në objekt.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se merr përsiper transportin e mallrave sipas nevojës së AK, deri në vendin e përcaktuar për magazinim pranë Zyra të Drejtorisë të Sherbimit Publik, Bashkia Dimal.

- Makinerite dhe pajisjet në pronesi të shoqërohen me akt pronesie original ose fotokopje e noterizuar.
- Për mjetet që shenohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti)
- Për pajisje e tjera duhet të jepen aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, origjinale ose fotokopje e noteruar.
- *Shënim:* Per këte pike te mesiperme operatorët ekonomik në fazën e ofertimit duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.
- **Argumentimi:** Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi janë hartuar/pecjell pranë sektorit të prokurimeve me ane të kërkesës për prokurim nga Drejtoria e Sherbimit Publik, bazuar në nenin 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Përsa i përket vlerës të fondit limit përlllogaritja është bërë nga grupi i përlllogaritjes së fondit limit, si dhe bazuar në vendimin Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së dokumentit, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT